


**Përgatiteni daljen
në pension, në Zvicër
apo jashtë**



Udhërrëfyes për personat e migruar



L a u s a n n e





Botues

Bureau lausannois pour
les immigrés-BLI

Redaktimi

Katja Haunreiter,
Profesoreshë, në
Shkollën e lartë të
punës shoqërore dhe
shëndetit (EESP) në
bashkëpunim me BLI-në
dhe Agjencinë e
sigurimeve shoqërore
(Agence d'assurances
sociales) të Qytetit të
Lozanës

Dizajni

DADA design,
Myriam Jung

Shtypja

Courvoisier-Attinger
Arts Graphiques SA

Përkthimi

Interserv SA Lausanne

© BLI-Ville de
Lausanne, maj 2018

Zyra lozaneze për të imigruarit (BLI) i shpreh gjithë mirënjohjen e vet Zonjës Katja Haunreiter, profesoreshë e së drejtës, për punën e saj për redaktimin dhe përhapjen, si dhe për kontributin e saj thelbësor në «ateli të për përgatitjen e daljes në pension».

Lënda

Edito

Hyrje

1. Tri shtyllat në Zvicër

2. Pensioni në kuadrin e shtyllës së parë (premier pilier-LAVS)

3. Pensioni në kuadrin e shtyllës së dytë (deuxième pilier-LPP)

Shtylla e parë dhe e dytë shkurtimisht

4. Ndhimat plotësuese të shtyllës së parë (LPC për AVS-në)

5. Pensioni në kuadrin e shtyllës së tretë (troisième pilier-LCA)

6. Aspektet fiskale në moshën e pensionit

7. Largimi nga Zvicra në moshën e pensionit

8. Ndhimat për të moshuarit në Lozanë dhe në kantonin e Vaudit

9. Adresa të dobishme sipas rendit alfabetik

10. Leksik

4 

5 

6 

9 

20 

26 

28 

32 

36 

38 

42 

47 

50 

Edito

Hyrja në fuqi e Sigurimit për Pleqërinë dhe të Mbijetuarit (AVS) përbën, pa kundërshtim, një prej përparimeve më të mëdha shoqërore të vendit tonë në shekullin XX. Megjithatë, nga viti 1918 deri në vitin 1947, ka pasur debate të forta, deri sa, më në fund, në janarin e vitit 1948, u arrit në derdhjen e pensioneve të para nga AVS-ja. Ky përparim shoqëror do të thotë gjithashtu se tash e tutje pensioni njihet si një etapë e rëndësishme e jetës, gjatë së cilës mund të jetohej në mënyrë të dinjitetshme.

Sidoqoftë, edhe gjatë këtyre viteve të fundit, debate të zjarra mbi parashikimin shoqëror, qoftë lidhur me moshën e daljes në pension apo me financimin e tij, kanë zënë pareshtur hapësirën publike, duke pasur në shënjestër çështjet që lidhen me plakjen demografike. Ky botim del në dritë në një kontekst të lëvizshëm, ku qëndrojnë ende shumë pikëpyetje lidhur me të ardhmen e sistemit tonë të pensioneve. Duke qenë se u drejtohet para së gjithash personave të migruar, ai botohet në shtatë gjuhë (shqip, anglisht, boshnjakisht, spanjisht, frëngjisht, italisht dhe portugalisht), me qëllim që ta bëjë të kuptueshëm sistemin tonë të ndërlikuar të pensioneve. Nga pikëpamja jonë, të ndihmohet në bërjen e zgjedhjeve të mira në momentin e daljes në pension, do të thotë të bësh një hap për më shumë barazi të mundësive në drejtim të atyre, të cilët, përkrah nesh, kanë kontribuar

në zhvillimin ekonomik të vendit tonë dhe veçanërisht të kryeqytetit vaudez, 42% e popullsisë së të cilit nuk ka pasaportë zvicerane.

Sepse të kontribuosh për t'ju lehtësuar kuptimin e problemeve që lidhen me daljen tuaj të ardhshme në pension, të trajtosh çështjet specifike që kanë të bëjnë me ju si i migruar dhe t'ju lejosh që ta jetoni këtë etapë me qetësi, përbëjnë objektivat madhore të këtij botimi. I hartuar në një gjuhë të qartë, me shembuj konkretë dhe me adresa të dobishme, ky botim do të bëhet pa asnjë dyshim, i domosdoshëm edhe për të gjithë-a lozanezët-et në moshën e përgatitjes së daljes në pension, pavarësisht nga pasaporta e tyre.

Kjo nismë, ndër shumë të tjera, dëshmon për angazhimin e Lozanës në favor të të moshuarve të vet, duke pasur si objektiv kohezionin shoqëror. Ky angazhim i vendosur do të forcohet edhe më, me hyrjen e Qytetit të Lozanës në rrjetin botëror të Qyteteve Mike të të Moshuarve (Villes Amies des Aînés).

E dashur lexuese, i dashur lexues, ju që do të arrini së shpejti moshën e pensionit, ju uroj ta jetoni këtë etapë me dëshirë, shëndet e lumturi.

Oscar Tosato, këshilltar bashkiak
Drejtor i sporteve dhe kohezionit shoqëror

Hyrje

Një etapë e re në jetë.

Sot, dalja në pension shënon një etapë të re në jetë, e cila ofron mundësi që ndryshojnë sipas rrugëtimeve jetësore, gjendjes familjare dhe kushteve shoqërore dhe ekonomike të secilit. Sidoqoftë, ndërprerja përfundimtare e veprimtarisë fitimprurëse, të ushtruar shpesh gjatë disa dhjetëvjeçarëve, mund të jetë një cak i vështirë për t'u kaluar. Është mirë që të merret koha e duhur për të menduar për çështjet konkrete që lidhen me këtë ndryshim statusi, si në plan praktik edhe në atë financiar.

Para se të kalohet kjo etapë, duhet të parashikohet me kujdes një organizim i ri vetjak, i diskutuar po qe e mundur bashkë me të afërmit tuaj, sipas mënyrës tuaj të jetesës dhe mundësive tuaja. Është rasti për të pyetur veten mbi përparësitë tuaja sa i përket strehimit, shëndetit, argëtimeve. Ndoshta edhe për trajtimin e pyetjeve lidhur me angazhimin tuaj kolektiv, për shembull në formën e veprimtarive vullnetare.

Sot, prej punëdhënësve dhe organizmave aktive në favor të të moshuarve organizohen një sërë veprimtarish që synojnë t'ju lejojnë të përgatisni sa më mirë daljen tuaj në pension. Qysh prej vitit 2013, Zyra lozaneze për të imigruarit (BLI), në bashkëpunim me partnerë të shumtë, organizon “ate-

lie për përgatitjen e daljes në pension”, për lozanezet dhe lozanezët, pa pasaportë zvicrane, të moshuar nga 60 deri në 65 vjeç. Këto atelie synojnë të japin një hyrje në sistemin e pensioneve në Zvicër dhe lejojnë trajtimin e aspekteve më specifike sipas vendit të origjinës të pjesëmarrësve.

Ky botim përbën një përzgjatje të këtyre atelieve, të cilët kanë pasur shumë sukses. BLI-ja synon pra informimin me qëllim që t'ju lejojë ndërtimin e një jete në pension të lumtur, afër aspiratave tuaja. Njohja e rregullave në fuqi në Zvicër në fushën e pensionit, e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin prej tyre, si dhe e përçapjeve që duhet të ndërmerren paraprakisht, janë aspekte thelbësore për ta arritur atë. Nuk duhet lënë pas dore në asnjë mënyrë: informimi juaj mbi gjendjen tuaj financiare të ardhshme.


Çdo rrugëtim është vetjak... Por organizma të shumtë, aktivë në favor të të moshuarve, janë gati t'ju shoqërojnë në rrugën tuaj.

Gabriela Amarelle,
e deleguar për integrimin



1.

Tri shtyllat në Zvicër



1. Nocioni i rrezikut

Gjatë ekzistencës së tij njeriu përballlet me rreziqe të ndryshme: fjala është pikërisht për sëmundjen, aksidentin, invaliditetin, madje edhe për papunësinë.

Kur këto rreziqe ndodhin, personi i interesuar mund të gjendet jo vetëm në vështirësi vetjake por edhe financiare.

Me qëllim që të kufizohen pasojat e të papiturave të jetës, sigurime të ndryshme, në veçanti shoqërore, janë krijuar: në parim përmes derdhjes të detyrueshme të kontributeve ose kuotizacioneve, individit mund të marrë përfitime, shpesh në të holla, të cilat e ndihmojnë për të kapërcyer vështirësinë me të cilën përballlet.

2. Sistemi i quajtur i “tri shtyllave” (“trois piliers”)

a) Parimi

Neni 111 paragrafi 1 i Kushtetutës federale parashikon se “Konfederata merr masa për të siguruar një parashikim (prévoyance) të mjaftueshëm për pleqërinë, të mbijetuarit dhe invaliditetin. Ky parashikim qëndron mbi tri shtylla që janë sigurimi federal për pleqërinë, të mbijetuarit dhe invaliditetin, parashikimi profesional dhe parashikimi individual”.

b) Rreziqet e parashikuara

Me anën e këtij sistemi, qëllimi është që të ngrihet një sistem që mundëson kufizimin e pasojave financiare që rrjedhin nga ndodhja e tri rreziqeve që janë:

- **pleqëria**: është e domosdoshme që personave që mbushin moshën e pensionit t’u sigurohet një e ardhur me qëllim që të zëvendësojnë, të paktën pjesërisht, rrogën apo honoraret e fituara deri në momentin e daljes në pension

- **humbja e mbështetjes**: vdekja e parakohëshme e një personi i lë të afërmit e tij (bashkëshortin.en apo partnerin.en e regjistruar dhe fëmijët deri në 25 vjeç nëse ata janë me studime) pa mjete financiare, prandaj është e nevojshme që ato të plotësohen me derdhjen e pensionit për të ve dhe jetimë

- **invaliditeti**: kur një problematikë shëndetësore ka për pasojë kufizimin për një kohë të gjatë të ushtrimit të një profesioni apo të kryerjes së detyrave të përtidshme, duhet që kjo vështirësi të përballohet me masa ripërshtatjeje (réadaptation) apo me derdhjen e një pensioni.

c) mbulimi i rreziqeve

E drejta zvicerane parashikon që këto tri rreziqe të jenë të mbuluara, në parim në mënyrë të mbledhshme, nga



• **Shtylla e parë**, që përbëhet nga sigurimi për pleqërinë (assurance-vieillesse et survivants -LAVS) dhe sigurimi invalidor (assurance-invalidité -LAI) dhe që prek tërë popullsinë që banon legalisht në Zvicër; përgjegjësia për këto sigurime i takon Shtetit i cili siguron mbledhjen e kuotizacioneve që rrjedhin prej tyre.

• **Shtylla e dytë**, që përfaqësohet nga parashikimi profesional (prévoyance professionnelle -LPP) dhe që si rregull i përgjithshëm rezervohet për rrogetarët et që duhet të kenë hyrë në një arkë pensioni; përgjegjësia për këtë shtyllë u takon punëdhënësve.

• **Shtylla e tretë**, pikërisht kursimi vetjak, për shembull në formën e një sigurimi jete (assurance-vie -LCA), që mund të bëhet nga çdo person që zotëron mjete financiare të mjaftueshme; ajo është në përgjegjësinë individuale.

Dy shtyllat e para janë objekt i sigurimeve shoqërore të detyrueshme, ndërsa e treta e një sigurimi privat të mundshëm, i cili është i padetyrueshëm dhe varet nga të ardhurat mujore që zotëron personi i interesuar.

Pauli, pejzazhisht te firma Fleurs SA, vdes në moshën 49 vjeçare nga pasojat e një kanceri. Ai lë të shoqen dhe dy fëmijë të moshës 15 e 17 vjeç.

Të afërmeve të tij do t' u jepet një pension për të mbijetuerit si nga ana e arkës së

kompensimit (shtylla e 1rë, LAVS) edhe nga arka e pensionit (shtylla e 2të, LPP) në të cilat Pauli ka qenë i anëtarësuar.

Nëse Pauli do të kishte kontraktuar edhe një sigurim privat, në veçanti një sigurim jete (LCA), gruaja dhe dy fëmijët e tij do të përfitonin edhe një kapital nga ana e siguruesit që ai do të kishte zgjedhur vetë.

Nëse shumat që një person zotëron në saje të këtij sistemi nuk mjaftojnë për mbulimin e nevojave bazë, mund të jepen edhe ndihma poltësuese (prestations complémentaires-LPC) në plotësim të pensioneve të derdhura (shih faqen 27).



2.

**Pensioni në kuadrin e
shtyllës së parë** (premier pilier-LAVS)



1. Moshja e pensionit: të përgjithshme

Në Zvicër, dalja në pension në kuadrin e shtyllës së 1rë (LAVS) parashikohet për moshën 64 vjeç për gratë, 65 vjeç për burrat¹: fjala është për moshën e pensionit, ndërsa e drejta e pensionit lind ditën e parë të muajit që vjen pas atij të moshës të parashkruar. Pensioni derdhet në datën 20 të çdo muaji.

Nga çasti që i siguruari mbush moshën e pensionit, detyrimi i tij për të kuotizuar në sigurimet shoqërore të shtyllës së 1rë (LAVS) e të shtyllës së 2të (LPP) pushon, veç po që se ai vazhdon një veprimtari fitimprurëse².

Përkundrazi, dalja në pension nuk ndikon në detyrimin për të pasur sigurim mjekësor: çdo person me banim në Zvicër, pavarësisht nga moshja, duhet të përfitojë nga sigurimi mjekësor (LAMal) për të mbuluar shpenzimet e tij mjekësore, pasi të ketë paguar frankizën (franchise) e zgjedhur prej tij dhe kuotën e pjesëmarrjes në ngarkim të tij (quote-part). Zyra vaudeze e sigurimit mjekësor (Office vaudois de l'assurance-maladie -OVAM) informon mbi të drejtën e mundshme për të marrë ndihmë financiare për pagimin e kontributeve mujore (shih kapitullin 9, f.47).

Ana-Maria feston 64-vjetorin më 17 janar: e drejta e pensionit të shtyllës së 1rë i lind më 1 një shkurt dhe pensioni i parë do t'i derdhet efektivisht më 20 shkurt³.

Sveni feston 65-vjetorin më 1 shtator: e drejta e pensionit e shtyllës së 1rë i lind më 1 tetor dhe pensioni i parë do t'i derdhet efektivisht më 20 tetor.

2. Moshja e pensionit për personat që nuk ushtrojnë veprimtari profesionale

Sistemi zviceran parashikon se çdo person duhet të kuotizojë në sigurimin e pleqërisë (LAVS), në sigurimin invalidor (LAI) dhe në sigurimin e humbjes së fitimit në rast shërbimi ushtarak dhe mëmësie (assurance perte de gain -LAPG) që nga çasti që

- ai ushtron një veprimtari fitimprurëse dhe që është mbi 17 vjeç⁴: edhe të rinjtë që për shembull janë duke nxënë një profesion (për marrjen e një certifikate federale të aftësisë-CFC) i shlyejnë këto kuotizacione
- ai është 20 vjeç⁵ dhe nuk ka ndonjë veprimtari me pagesë: kështu, edhe studentët.et duhet të kuotizojnë në këto sigurime.

Kuotizacioni që mblidhet në mungesë të veprimtarisë fitimprurëse quhet “më i ulit⁶”, shumja e tij është rreth CHF 500.- /në vit, për

- a) studentët.et deri në 25 vjeç e shumta
- b) personat që marrin përfitime nga ndihma shoqërore.



- 1 Neni 21 LAVS
- 2 Neni 3 LAVS
- 3 Neni 72 RAVS
- 4 Neni 3 par. 2 lit a LAVS : që nga 1 janari që pason 17 vjetorin
- 5 Neni 3 par. 1 LAVS : që nga 1 janari që pason 20 vjetorin
- 6 Neni 10 par. 2 LAVS

Mëpastaj, shuma e kuotizacioneve përcaktohet prej arkës kompetente të kompensimit në bazë të pasurisë dhe të të ardhurave nga pensionet, me përjashtim të atyre që përfitojnë në kuadrin e invaliditetit⁷ dhe të ndihmave plotësuese (LPC). Nga kjo rrjedh që një person që ka kërkuar derdhjen e parakohshme të pensionit të pleqërisë duhet të vazhdojë të shlyejë kuotizacionet AVS-AI-APG deri në moshën limite prej 64 vjeçësh për gratë dhe 65 vjeçësh për burrat.

Ky sistem, kompleks, lejon shmangien e boshllëqeve në kuotizacione, boshllëqe që ndikojnë në shkallën e pensionit dhe në shumën që mund të përfitohet prej të siguruarve.ave

Sidoqoftë, duhet të mbajmë në mendje se për disa persona “quhet se i kanë paguar kuotizacionet” edhe pse ata nuk kanë kryer asnjë derdhje. Kështu, quhet se i kanë paguar vetë kuotizacionet personat, kur bashkëshortja / bashkëshorti apo partneri,ja i.e regjistruar i.e tyre ka derdhur të paktën dyfishin e kuotizacionit minimal⁸.

Me lindjen e një fëmije, prindër të shumë vendosin që njeri prej tyre të qëndrojë në shtëpi, qoftë për disa muaj, qoftë për shumë vite. Gjatë kësaj periudhe kohe, prindi pa veprimtari nuk do të kuotizojë drejtpërdrejt: e drejta zvicerane e quan se ai ka kuotizuar përmes bashkëshortit kur ky është rrogëtar apo i pavarur (i vetpunësuar).

Kështu, edhe nëse nuk ka zënë asnjë punë, personi mund të pretendojë për pension pleqërie në kuadrin e shtyllës së 1rë (LAVS) në moshën limite duke qenë se edhe ai ajo ka kuotizuar në sigurimet shoqërore të detyrueshme, qoftë vetë, qoftë përmes bashkësorës të tij apo bashkëshortit të saj⁹.

Klaudia nuk ka ushtruar veprimtari fitimprurëse qysh nga lindja e fëmijës së parë dhe i është përkushtuar familjes gjatë 30 vjetëve.

Tani ajo është 63 vjeç dhe është e martuar me Havierin, 60 vjeç, rrogëtar në Shtetin e Vaudit. Ajo feston 64 vjetorin më 17 nëntor.

Që nga 1 dhjetori, ajo mund të pretendojë për pension pleqërie në kuadrin e shtyllës së 1rë (LAVS), edhe nëse nuk ka pasur më punë prej vitesh.

3. Pensioni i parakohshëm

a) Pensioni i pleqërisë i shtyllës së 1rë (LAVS)

Dalja në pension të parakohshëm është e mundur¹⁰, por jo para moshës 62 vjeç për gratë dhe 63 vjeç për burrat. Sidoqoftë, kjo dalje në pension të parakohshëm do të ketë si pasojë pakësimin përfundimtar të shumës së pensionit, pakësim që mund të shkojë nga



7 Neni 28 par. 1 RAVS

8 Neni 3 par. 2 LAVS

9 Neni 3 par. 3 LAVS

10 Neni 40 LAVS - neni 56 par. 2 RAVS

- 6,8% (për një vit para kohe) në
- 13,6% (për dy vjet para kohe).

Pensionin mund të merret para kohe vetëm për një vit të plotë: nuk është e mundur për shembull që pensioni i pleqërisë të shtyllës së 1rë (LAVS) të merret gjashtë muaj para kohe.

b) Pensioni-urë (Rente-pont)

Në kantonin e Vaudit, kur një i.e siguruar nuk ka të drejtë apo nuk ka më të drejtë për të përfituar pagesat ditore (indemnités journalières) të sigurimit të papunësisë, është e mundur, në disa raste, të marrë një pension të quajtur “urë” (pont) qysh prej moshës 62 vjeç për gratë, 63 vjeç për burrat, kjo për të mbuluar periudhën kohore deri në derdhjen e pensionit të pleqërisë në moshën limite pa kërkuar ndihmë shoqërore apo pa qenë i.e detyruar për të kërkuar pensionin e parakohshëm të shtyllës së 1rë (LAVS).

Në disa raste, pensioni-urë mund të fillojë në moshën 60 vjeç për gratë dhe 61 vjeç për burrat.

Duke qenë se kushtet e dhënies të një pensioni të tillë përcaktohen në mënyrë individuale në funksion të gjendjes financiare të hollësishtme të të siguruarit.ës, duhet të merret kontakt me qendrën rajonale të vendimeve të pensionit-urë (shih listën me adresat në shtojcë).

c) Pensioni i shtyrë (Retraite ajournée)

Shtyrja e pensionit të pleqërisë të shtyllës së 1rë (LAVS) do të thotë “të mos shkosh në pension në moshën limite” dhe të jetosh me pasurinë tënde apo ta mbash punën, qoftë si i pavarur (i vetpunësuar) apo si rrogëtar.

Një i.e pavarur mund të vendosë lirisht të vazhdojë veprimtaritë e veta profesionale, ndërsa një rrogëtar.e nuk mund ta bëjë këtë veç po të ketë miratimin paraprak të punëdhënësit të tij: në fakt, nuk ekziston e drejta për të qëndruar në vendin e vet të punës pas moshës limite.

Moskërkimi i derdhjes së pensionit të shtyllës së 1rë (LAVS) në moshën limite ka për pasojë që, kur më në fund ai të merret, shuma e tij të rritet për jetë

- Nga 5,2% (1 vit shtyrje të paktën) dhe
- 31,5% (5 vjet shtyrje e shumta)¹¹.

Kohëzgjatja e shtyrjes është nga 1 vit (e pakta) deri në 5 vjet (e shumta) dhe mund të përcaktohet lirshëm, pas 12 muajve të parë: kështu për shembull është e mundur që ai të shtyhet për shtatëmbëdhjetë muaj, ndryshe nga pensioni i parakohshëm, i cili mund të kërkohej vetëm për “periudha njëvjeçare të plota”¹².

Kuotizacionet shoqërore të zakonshme (AVS-AI-APG) vazhdojnë të zbriten nga rroga e fituar / honoraret e faturuara por kjo vetëm për shumat që i kalojnë CHF 1'400.-/muaj (apo CHF 16'800.-/vit)¹³.



11 Neni 55ter
RAVS

12 Art. 40
al.1 LAVS, Art.56
al.2 RAVS.

13 Neni 6quater
RAVS

Kuotizacionet e paguara pas moshës limite nuk e modifikojnë shkallën e pensionit (shih kapitullin tjetër).

Shtyrja e pensionit nuk është e mundur për personat që janë përfitues të pensionit invalidor: në moshën limite, pensioni i tyre në parim “kthehet” në pension pleqërie¹⁴.

d) Shkalla e pensionit të shtyllës së 1rë (LAVS)

Shuma e përfituar çdo muaj në kuadrin e pensionit të pleqërisë të shtyllës së 1rë (LAVS) përcaktohet nga tri elemente kryesore¹⁵:

1. Numëri i viteve i kuotizacioneve të paguara në Zvicër: është ai që përcakton **shkallën**, pikërisht shumën më të ulët dhe më të lartë që mund të përfitohet prej të siguruarit.ës, duke qenë se këto shkallë shkojnë nga 1 vit (kuotizim në Zvicër) në 44 e shumta (kuotizacione të paguara duke filluar nga mosha 20 vjeç deri në moshën limite të daljes në pension):

2. Shumat e fituara çdo vit (rrogë / honorare për të pavarurit): ato të fituara gjatë tërë veprimtarisë së ushtruar në Zvicër do të shërbejnë si bazë për të caktuar shumën e saktë që mund të përfitohet në kuadrin e pensionit të pleqërisë të shtyllës së 1rë (LAVS), midis shumës më të ulët dhe asaj më të lartë të shkallës të caktuar parapra-kisht

3. Gjendja familiare e të siguruarit gjatë këtyre viteve: të ardhurave të fituara efektiviht prej të sguaruarit.ës u shtohen edhe shumat për detyra **edukative** (tâches éducatives)¹⁶ apo **ndihmëse** (d’assistance) ndaj një prindi në vijë paralindëse (prindërit e vet pensionistë), paslindëse (një fëmijë me aftësi të kufizuara në moshë madhore) apo vëllezërit e motrat e veta nëse ata.ato janë përfitues.e të pensioneve të shtyllës së 1rë (invaliditet apo pleqëri) dhe marrin një alokacion për pafuqi (impotence) nga AI-ja, nga AVS-ja apo nga sigurimi i detyrueshëm për aksidentet¹⁷ për arësye të një pafuqie të mesme apo të rëndë. Shtesat për detyra ndihmëse dhe edukative nuk mund të mblihdhen me njera tjetrën¹⁸.

Sot, pensioni në shkallën 44 (shkalla më e lartë) është midis CHF 1’175.-/muaj dhe CHF 2’350.-/muaj.

Një person që ka marë, mesatarisht gjatë tërë ekzistencës së vet, një të ardhur më të ulët se CHF 14’100.-/vit, do të përfitojë një pension mujor prej CHF 1’175.- ; duhet që e ardhura mesatare gjatë një rrugëtimi të tërë profesional të ketë qenë CHF 84’600.-/vit që të pretendohet për një pension prej CHF 2’350.-/muaj në kuadrin e shtyllës së 1rë (LAVS).

“Shkallët” e ndryshme (tabelat e pensioneve AVS/AI) mund të konsultohen në sitin internet të Zyrës federale të sigurimeve shoqëro-



14 Neni 55bis RAVS

15 Neni 29bis LAVS

16 Neni 29septies LAVS

17 Neni 29 septies par. 1 LAVS

18 Neni 29septies par. 2 LAVS

re (Office fédéral des assurances sociales -OFAS).

Fabiana ka ardhur në Zvicër në moshën 8 vjeç. Ajo ka kuotizuar qysh nga fillimi i formimit profesional dhe del në pension në moshën limite.

Pensioni i saj është i shkallës 44 dhe do të jetë midis CHF 1'175.-/muaj nëse e ardhura vjetore mesatare e saj gjatë ekzistencës së saj ka qenë më e ulët se CHF 14'100.- dhe CHF 2'350.-/muaj nëse kjo e ardhur vjetore mesatare ka qenë të paktën CHF 84'600.-.

Fabricioja ka gjetur punë qysh me mbërritjen e tij në Zvicër; ai do të dalë në pension pas plot 35 vjetëve veprimtari: ai do të jetë atëherë në shkallën 35 (pensioni më i ulët: CHF 935.-/muaj, pensioni më i lartë CHF 1'870.-/muaj).

Shuma ekuivalente e pensionit të pleqërisë të shtyllës së 1rë (LAVS) të Fabricios përcaktohet prej shumës që ka fituar gjatë jetës së tij profesionale në Zvicër dhe prej gjendjes familjare të tij (në veçanti prania apo jo e fëmijëve që gjithashtu jetojnë në Zvicër): ajo do të jetë midis shumave të dhëna më sipër.

Fransuaza, 58 vjeç, veç punës si receptioniste me 70% në një hotel, kujdeset çdo ditë për nënën e vet, e cila merr nga AVS-ja një alokacion për pafuqi të mesme apo të

rëndë dhe jeton në të njëjtën lagje si ajo. Me kërkesën e saj (e cila duhet ripërtërirë çdo vit pranë arkës kantonale të kompensimit të vendbanimit të personit të ndihmuar, "të ardhurat vjetore" të saj do të kreditohen me një shumë prej CHF 42'300.- në vit për shërbimin ndaj të ëmës. Kjo shumë ndahet më dysh nëse Fransuaza është e martuar; me gjysmën tjetër kreditohet llogaria e të shoqit të saj¹⁹.

Kërkesa për shtesën për detyra ndihmëse (tâches d'assistance) duhet të bëhet brenda pesë vjetëve duke llogaritur nga fundi i vitit civil gjatë të cilit personi i ka dhënë ndihmë të afërmit të vet²¹.

Fabiani kujdeset rregullisht për të ëmën, 78 vjeç, qysh nga 1 janari 2009. Ai ka afat deri më 31.12.2013 për të kërkuar regjistrimin e shumës së shtesës për detyra ndihmëse në llogarinë e vet pranë arkës së kompensimit.

e) Projektimi (Parashikimi)

Është e mundur të bëhet një projektim (parashikim)²⁰ i të drejtës për pension, për moshën limite apo për pensionin e parakohshëm, pranë arkës së kompensimit kompetente për mbledhjen e kuotizacioneve në momentin e këskesës²²: ky projektim bën të mundur njohjen qysh përpara të shumës që do të mund të merret përmes pensionit të pleqërisë në kuadrin e shtyllës së 1rë (LAVS), gjë që mund të jetë me interes për



19 Neni 29septies par. 6 LAVS

20 Neni 29septies par. 5 LAVS

21 Neni 58 RAVS

22 Neni 59 RAVS

- të parashikuar në mënyrë konkrete një dalje të mundshme në pension të parakohshëm
- për të parë mundësinë e shtyrjes të derdhjes së pensionit
- për të planifikuar në mënyrë të përgjithshme daljen në pension, pikërisht në planin buxhetor.

Këkesa është falas nëse bëhet pas moshës 40 vjeç dhe mund të ripërtërihet pa shpenzime çdo 5 vjet ; kërkesa në hapësira kohore më të shkurtra mund të bëhen nëse ato arsyetohen me motive të veçanta (si martesë, divorci, lindja e një fëmije, humbja e punës)²³.

f) Pensioni për fëmijë²⁴

Nëse, në momentin e daljes në pension, një i.e siguruar ka në ngarkim një apo disa fëmijë të moshës deri në 18 vjeç apo më të moshuar që ende janë në shkollë, ai mund të përfitojë pension plotësues për ta gjatë kohës që ata janë me studimeve, e shumta deri sa të mbushin moshën 25 vjeç²⁵.

Shuma e këtij pensioni plotësues është në funksion të shumës së atij të prindit që ka mbushur moshën e pensionit: ajo arrin në 40% të pensionit të përfutur prej prindit në pension²⁶.

Huani feston 65 vjetorin më 17 shtator në praninë e gruas së vet, të moshës 59 vjeç, dhe të dy vajzave të tij, të moshës 17 dhe 22 vjeç. E madhja bën studime ingjinerie

në Iverdon ndërsa e vogla është në vitin e 3të të formimit si desinatore në një ndër-marrje lozaneze.

Huani përfiton një pension pelqërie në kuadrin e shtyllës së 1rë (LAVS) prej CHF 1'985./muaj. E drejta e pensioneve për fëmijët me një shumë prej CHF 794./muaj për fëmijë i lind më 1 tetor²⁷.

Asnjë pension për fëmijë nuk derdhet në kuadrin e shtyllës së 1rë (LAVS) në rast pensioni të parakohshëm²⁸, kjo gjë gjatë një viti, madje dy vjetësh, e deri sa i.e siguruari.a të arrijë moshën e pensionit 64 vjeç (grua), përkatësisht 65 vjeç (burrë).

Mund të ekzistojë edhe e drejta e pensionit për fëmijë në kuadrin e shtyllës së 2të (LPP) (shih faqen 24), të cilin i.e siguruari.a mund ta marrë në mënyrë të mbledhshme (cumulativement).

g) Pension për çift

Që nga çasti që të dy bashkëshortët, të martuar apo partnerë të regjistruar, mbushin moshën e pensionit, pensioni për të dy sëbashku nuk mund të kalojë 150%²⁹ të pensionit të pleqërisë më të lartë të shtyllës së 1rë (LAVS): pensioni më i lartë është CHF 2'350./muaj, ndërsa 150% përfaqësojnë CHF 3'525./muaj. Pensioni i dy bashkëshortëve apo partnerëve të regjistruar sëbashku nuk mund ta kalojnë këtë shumë.



23 Neni 58 par. 3 RAVS

24 Neni 22ter LAVS

25 Neni 25 par. 5 LAVS

25 Neni 35ter LAVS

27 Neni 25 par. 4 LAVS

28 Neni 40 par. 1 LAVS

29 Neni 35 par. 1 LAVS

Prandaj bëhet një përlogaritje e re e pensionit të pleqërisë, që nuk është mbledhja e dy pensioneve të thjeshta por një pension i quajtur për “çift”.

Zhaneta, 64 vjeç, dhe Françeskoja, 68 vjeç, janë martuar qysh prej 25 vjetësh. Tani ata janë pensionistë që të dy. Arka kompetente e kompensimit ka përcaktuar shumën e secilit pension individual në kuadrin e shtyllës së 1rë (LAVS):

Zhaneta : CHF 2'010./muaj (në shkallën 44)

Françeskoja : CHF 2'200./muaj (në shkallën 44), që përfaqëson një shumë të përgjithshme prej CHF 4'210.-.

Pensioni i Zhanetës do të jetë $\frac{2'010 \times 3'525}{4'210} = 1'682.85$, i rrumbullakosur në CHF 1'683./muaj³⁰

Pensioni i Françeskos do të jetë $\frac{2'200 \times 3'525}{4'210} = 1'842.04$, i rrumbullakosur në CHF 1'842./muaj

h) Të qenit i.e ve dhe pensioni i pleqërisë i shtyllës së 1rë (LAVS)

Nëse një person i ve i përmbush në të njëjtën kohë kushtet si për marrjen e pensionit si i.e ve edhe të pensionit të pleqërisë, ai do të përfitojë vetëm pensionin më të lartë.³¹

Antonioja vdes në moshën 54 vjeç në një aksident të qarkullimit rrugor. Ai le pas gruan, Zhasminën, 50 vjeç, dhe dy fëmijë

të moshës 15 e 17 vjeç.

Prej atëherë Zhasmina përfiton një pension për të ve të shtyllës së 1rë (LAVS) prej CHF 1'762.- dhe dy pensione për jetimë me nga CHF 705./muaj për secilin fëmijë. Derdhja e pensioneve për fëmijë u ndërpre në fund të studimeve të të dy djemve, e shumta pasi ata mbushën moshën 25 vjeç.

Sikur Antonioja të kishte qenë rrogëtar, Zhasmina dhe dy djemtë e saj do të mund të përfitonin edhe një pension për të ve / jetimë në kuadrin e shtyllës së 2të (LPP) si dhe një pension për të ve / jetimë prej sigurimit për aksidentet (LAA) që kishte punëdhënësi i Antonios në momentin e vdekjes.

Tani, që ka mbushur moshën 64 vjeç, Zhasmina del në pension. Në kuadrin e shtyllës së 1rë (LAVS) asaj do t'i takonte një pension pleqërie prej CHF 1'550./muaj, por ajo do të vazhdojë të përfitojë shumën më të lartë, pikërisht CHF 1'762./muaj në vend të pensionit të shtyllës së 1rë (LAVS).

Pensioni për të ve i shtyllës së 2të (LPP) dhe pensioni për të ve i sigurimit për aksidentet (LAA) vazhdojnë t'i derdhen deri në vdekjen e saj³² ose deri në një rimartese të mundshme të saj.

Tania dhe Zhorzhi, të martuar, janë që të dy në pension. Pensioni i pleqërisë i shtyllës së 1rë(LAVS) i Tantias është CHF 1'762./muaj, ndërsa ai i Zhorzhit CHF

30 Neni 53 par.
2 RAVS

31 Neni 24b
LAVS

32 Neni 22 par.
2 LPP

1'763.-/muaj.

Këtyre dy pensioneëve u është vënë një tavan pasi shuma e të dyve pa tavan i kalonte 150% të pensionit më të lartë.

Zhorzhi vdes në moshën 69 vjeç pas një sëmundjeje të gjatë. Atëherë, pensionit të Tanias i hiqet tavan. Shuma e tij atëherë është CHF 1'974.-/muaj pastaj ai rritet me një shtesë për të ve që përkon me 20 % të shumës së pensionit.

Kështu, që nga muaji që vijon muajin e vdekjes së Zhorzhit, shuma që i derdhet Tanias nuk do të jetë më CHF 1'762.- por CHF 2'350.-/muaj.

Nëse, pavarësisht nga heqja e tavanit dhe nga dhënia e shtesës për të ve, shuma e pensionit është më e ulët se shuma e pensionit më të lartë për të ve (CHF 1'800.-), arka do të verifikojë plotësimin e kushteve të dhënies së pensionit për të ve dhe do të kryejë një krahasim midis pensionit për të ve, (i cili përkon në mënyrë skematike me 80% të pensionit të pleqërisë të të ndjerit) dhe pensionit të pleqërisë për të mbijetuarit me shtesën për të ve. Shuma më e lartë do t'i derdhet atëherë bashkëshortit mbijetues.

i) Alokacionet për pafuqi

Kur një person, për shkak të cënimit të shëndetit, ka nevojë në mënyrë të zgjatur për ndihmën e një tjetri apo për një përkujdesje vetjake për të kryer veprimet e jetës

së përditshme³³, ai mund të bëjë, vetë apo me ndërmjetësimin e përfaqësuesit të tij, një kërkesë pranë arkës kantonale të kompensimit me qëllim që të përfitojë alokacionet për pafuqi, të cilat i shtohen pensionit të pleqërisë të shtyllës së 1rë (LAVS).

Quhet i.e pafuqi një i.e siguruar që ka nevojë për ndihmë për

- t'u veshur - për t'u zhveshur
- për t'u ngritur, për t'u ulur, për t'u shtrirë
- për të ngrënë
- për t'u pastruar
- për të shkuar në banjë
- për të lëvizur.

Kur ndihma e kërkuar ka të bëjë vetëm me dy veprime të jetës së përditshme, do të flitet për pafuqi të vogël; pafuqia do të quhet e mesme nëse personi ka nevojë për ndihmë njëkohësisht për të paktën dy veprime dhe për një përkujdesje vetjake të përherëshme. Pafuqia gjykohet e rëndë nëse tërësia e këtyre gjesteteve mund të bëhet vetëm me ndihmë dhe përkujdesje vetjake³⁴.

Kështu, pensionit të pleqërisë të shtyllës së 1rë (LAVS) do t'i shtohet edhe një shumë prej CHF 235.-/muaj (pafuqi e vogël), prej CHF 588.-/muaj (pafuqi e mesme) dhe prej CHF 940.-/muaj (pafuqi e rëndë).



33 Neni 9 LPGA
34 Neni 66bis
RAVS - neni 37
RAI

Alokacioni për pafuqi të vogël hiqet kur personi i interesuar qendron apo jeton në azile (home)³⁵.

Maliqi, 79 vjeç, nuk arrin më të pastrohet e të vishet vetë / as të zhvishet vetë: prej dy vjetësh ai përfiton alokacione për pafuqi të vogël.

Për të lehtësuar rrethin e tij që e mbështet në mënyrë të shpeshtë, ai bën qëndrime të shkurtra në një ent mjekësoro-shoqëror (Etablissement médico-social -EMS) të rajonit. Gjatë këtyre periudhave të shkurtra, alokacioni i pritët.

j) Mjetet ndihmëse

Një përfitues.e i.e pensionit të pleqërisë të shtyllës së parë (LAVS), banues.e në Zvicër, mund të marrë një mjet ndihmës

- për të përmbushur punët e tij të zakonshme
- për të lëvizur
- për të vendosur kontakte me rrethin e tij, ose
- për të zhvilluar mëvetësinë e tij vetjake³⁶.

Mjete ndihmëse janë për shembull karriget lëvizëse, zyzet-lupa, aparatet e dëgjimit apo këpucët ortopedike siç jepen në një listë specifike (urdhëresë lidhur me dhënie e mjeteve ndihmëse prej sigurimit të pleqërisë).

E drejta e mundshme për këto mjete ndihmëse lind që nga dita e parë e muajit për të cilin është derdhur një pension pleqërie i shtyllës

së 1rë (LAVS). Në parim mjete ndihmës nuk është kërkuar në ngarkim të siguruesit, i cili mjaftohet me një pjesëmarrje financiare prej 75%, pa marrë parasysh mjetet financiare (pasurinë dhe të ardhurat) që zotëron personi në pension.

Mjetet ndihmëse duhet të kërkojnë pranë zyrës kantonale të sigurimit invalidor (shih listën në shtojcë).

k) Veprimtaritë profesionale të ushtruara më përpara në një vend tjetër, jashtë Zvicrës

Një personi që nuk e ka kryer tërë karrierën e vet profesionale në Zvicër, në parim i takon të kërkojë të drejtat e tij për sa i përket pensionit edhe në vendin apo vendet ku ka punuar më përpara, sepse edhe atje ai ka kuotizuar në sigurimin shoqëror dhe, për këtë fakt, mund të pretendojë për përfitime në bazë të legjislacionit kombëtar përkatës.

Për shtetasit.et

- e Bashkimit europian (Union européenne -UE) apo të Shoqatës europiane të shkëmbimit të lirë (Association européenne de libre-échange -AELE), arka kompetente e kompensimit ka për detyrë që në momentin e daljes në pension të të siguruarit.ës, të ndërmarrë përçapjet e nevojshme për të mundësuar marrjen e pensionit të huaj. Për këtë qëllim, ajo kërkon që i.e siguruari.a të plotësojë formularin E207 (“të dhënat lidhur me karrierën e të siguruarit”) që do t’i dorëzohet atij.asaj, pasi ai.ajo ta ketë bërë kër-

35 Neni 43bis par. 1bis LAVS

36 Neni 2 par. 1 OMAV

kesën për marrjen e pensionit të pleqërisë në kuadrin e shtyllës së 1rë (LAVS),

- e vendeve të treta, i.e siguruari.a duhet t'i drejtohet Arkës Zvicerane të Kompensimit (Caisse Suisse de Compensation -CSC) në Gjenevë (shih kapitullin 9, f.47), e cila përcakton procedurën që duhet ndjekur, pasi ajo është e ndryshme nga një vend në tjetrin.

Mosha e daljes në pension nuk është një nocion i njëtrajtshëm, në plan botëror; ajo mund të jetë e ndryshme nga një vend në tjetrin. Prandaj ndodh që një person të quhet se është “në pension” në një vend, por ende jo në Zvicër: në një rast të tillë, në Zvicër, i.e si-guruaruari.a ose mund

1) të dalë në pension të parakohshëm ose, përkundrazi, mund

2) ta vazhdojë veprimtarinë e vet deri në mo-shën e pensionit, madje edhe përtej saj, duke e shtyrë atë. Në fakt, është e ligjshme që një person të përfitojë një pension të pjesshëm nga një vend i huaj, ndërkohë që në Zvicër vazhdon ushtrimin e profesionit të vet.

Pensioni i huaj i shtohet të ardhurave të përfituara në Zvicër dhe i nënshtrohet tatimeve si e ardhur.

1) Ndhimja shoqërore

Mirë është që kërkesa e pensionit të pleqërisë të bëhet, pak a shumë, gjashtë muaj para daljes në pension,

- pranë agjencisë të sigurimeve shoqërore të vendit të banimit (shërbimi i sigurimeve shoqërore për Lozanën, shih kapitullin 9, f.47) për pensionin e shtyllës së parë (LAVS). Për rrogëtarët, këto përçapje mund të bëhen edhe me ndërmjetësimin e punëdhënësit të fundit,

- pranë arkës së pensionit në të cilën ai ka hyrë për pensionin e shtyllës së 2të (LPP).

Bërja e kërkesës në mënyrë të mëvonëshme nuk e ndryshon aspak pasjen e të drejtës, por mund të sjellë një vonesë midis marrjes së rrogës të fundit dhe derdhjes së pensionit të parë të pleqërisë të shtyllës së 1rë (LAVS) ose të shtyllës së 2të (LPP).

Për arsye të kësaj vonese, dikush mund të ndodhet në vështirësi financiare për kryerjen e pagesave të zakonshme në fund të muajit.

Në një rast të tillë, i këshillohet personit të interesuar që t'i drejtohet sa më parë Shërbimit Shoqëror të Lozanës (Service Social de Lausanne -SSL, shih kapitullin 9, f.47) për të parë nëse i takon të përfitojë ndihmë shoqërore.

Shumat që me gjasë do të jenë derdhur në kuadrin e ndihmës shoqërore do të duhet të kthehen pasi të jenë dhënë pensionet “e prapambetura”³⁷.



37 Neni 46 par. 1 LAVS (RSV 850.051)

3.

**Dalja në pension në
kuadrin e shtyllës së
dytë** (deuxième pilier-LPP)



1. Parimi

Sipas nenit 113 paragrafi 2 të Kushtetutës federale, parashikimi profesional bashkë me sigurimin e pleqërisë, të të mbijetuarve dhe të invaliditetit duhet të lejojnë që i siguruari të ruajë në mënyrë të përshtatshme nivelin e tij të jetesës .

“Shtylla” e dytë synon të mbulojë po ato rreziqe si edhe ligji për sigurimin e pleqërisë dhe të të mbijetuarve (LAVS) dhe ligji për sigurimin e invaliditetit (LAI), pikërisht

- pleqërinë,
- humbjen e mbështetjes, dhe
- invaliditetin.

Shtylla e dytë, ashtu si edhe shtylla e parë, rregullohet prej ligjit federal: fjala është për ligjin mbi parashikimin profesional për pleqërinë, të mbijetuarit dhe invaliditetin (LPP).

Ky ligj përcakton parimet dhe rregullat që duhet të respektohen dhe të zbatohen nga të gjitha arkat e pensionit, të cilat i saktësojnë ato në një rregullore të posaçme të tyre. Prandaj, të dhënat e mëposhtme janë vetëm informacione të përgjithëshme, pasi dihet se sot në Zvicër egzistojnë 1'500 arka pensioni dhe secila prej tyre ka specifikat e veta që nuk mund të mbahen parasysh në këtë broshurë.

Informacione lidhur me gjendjen tuaj vetjake mund të merrni

- me anë të telefonit pranë arkës së pensionit në të cilën ka hyrë punëdhënësi juaj: në këtë rast është mirë të pajiseni me numërin e të siguruarit.ës, që gjendet në certifikatën tuaj vjetore
- në sitin e internetit të arkës përkatëse, pasi shumë arka pensioni japin informacione të dobishme në këtë mënyrë
- përmes certifikatës të parashikimit LPP që arka e pensionit duhet t’u japë çdo vit të gjithë personave të siguruar prej saj
- pranë punëdhënësit, përmes shërbimit të tij financiar apo departamentit të burimeve njerëzore.

Në fakt, një sigurues shoqëror, si për pensionet e shtyllës së 1rë edhe të 2të, ka detyrimin ligjor që t’i informojë të siguruarit. at mbi gjendjen e tyre³⁸. Ky detyrim ka të bëjë në realitet me të gjithë siguruesit, pra edhe me ata që administrojnë ndihmat plotësuese (prestations complémentaires -LPC) apo përfitimet për sëmundje (LAMal) për shembull.

2. Mosha limite

Pensionit i pleqërisë i shtyllës së 2të (LPP), ashtu si edhe pensioni i pleqërisë i shtyllës



së 1rë (LAVS), në parim jepen në moshën limite 64, përkatësisht 65 vjeç³⁹.

3. Pensioni i parakohshëm - pensioni i shtyrë

Disa arka pensioni, në rregulloren e tyre të parashikimit, parashikojnë se pensioni mund të merret edhe para moshës së pensionit, duke filluar nga mosha 58 vjeç⁴⁰.

Për sa kohë që i.e siguruari.a e vazhdon veprimtarinë e vet profesionale, pensioni mund të shtyhet e shumta deri në moshën 70 vjeç⁴¹.

Të siguruarit.at që vazhdojnë të ushtrojnë një veprimtari profesionale pas moshës së pensionit nuk e kanë më detyrimin për të kuotizuar. Por sidoqoftë, arkat e pensionit mund të parashikojnë në rregulloren e tyre të posaçme mundësinë për t'i mbajtur kuotizacionet, duke bërë në këtë mënyrë që të rritet shuma që do të mund të përfitohet kur pensioni të bëhet përfundimtar dhe të merret efektivisht.

4. Kuotizacionet

Gjatë veprimtarisë së vet profesionale, i.e siguruari.a që ushtron një veprimtari me rrogë ka detyrimin që të paguajë kuotizacione, në kuadrin e shtyllës së 2të (LPP). Ndërsa punëdhënësi duhet të shlyejë të paktën

të njëjtën shumë ndaj arkës së pensionit që do të ketë zgjedhur⁴².

Shuma e këtyre kuotizacioneve përcaktohet prej rregullores së posaçme të arkës në të cilën ka hyrë punëdhënësi.

Sidoqoftë, këto kuotizacione ndalen nga rroga detyrimisht vetëm

- kur rroga vjetore e përfitur pranë të njëjtit punëdhënësi arrin të paktën në CHF 21'150.- ⁴³në vit (CHF 1'762.50/muaj)
- kur kontrata e punës është bërë për një kohëzgjatje prej të paktën tre muajve⁴⁴
- mbi rrogën e përfshirë midis CHF 24'675.- (e quajtur zbritje bashkëndimi) dhe CHF 84'600.-/vit.

Të pavarurit.at (të vetpunësuarit) mund të hyjnë me dëshirë në një arkë pensionesh, por këtë nuk e bëjnë në mënyrë të vetësihme⁴⁵.

Svenit punon si montator-elektriçisht në një shoqëri lozaneze. Si i tillë, ai fiton CHF 57'350.- në vit Kuotizacioni lidhur me shtyllën e 2të (LPP) do të ndalet vetëm mbi shumën CHF 32'675.- (57'350 - 24'675), ndërkohë që rroga e plotë e Svenit do t'u nënshtrohet kuotizacioneve AVS-AI-APG (shtylla e 1rë) prej 5,125%. Rroga e plotë e Svenit do të jetë gjithashtu objekt i një zbritjeje prej 1,1% në kuadrin e sigurimit



39 Neni 13 par. 1 LPP

40 Neni 1i OPP2

41 Neni 33b LPP

42 Neni 113 par. 3 Cst federale

43 Neni 7 par. 1 LPP

44 Neni 1j par. 1 lit b OPP2

45 Neni 113 par. 2 lit d Cst federale

të papunësisë

Horhja ka dy punë, në dy ndërmarrje të ndryshme. Shuma e rrogave të tij të mbledhura sëbashku është CHF 36'000.-/vit; ai nuk do të sigurohet pranë një arke pensioni duke qenë se pranë të dy punëdhënësve fiton CHF 17'000.-/vit dhe CHF 19'000.-/vit.

5. Pensionet

a) Përcaktimi i pensionit

Mënyra e llogaritjes së pensionit mujor, që i takon të siguruarit.ës në momentin e daljes në pension, është shumë e ndryshme midis shtyllës së 1rë (LAVS) dhe shtyllës së dytë (LPP) dhe ndikohet gjerësisht prej rregullores së posaçme të secilës arkë pensioni.

Të gjitha arkat e pensionit duhet të mbajnë një "llogari pleqërie" për të siguruarit.at e vet. Në këtë llogari hyjnë kuotizacionet e derdhura prej punëdhënësit dhe të punësuarit.ës në arkën e pensionit dhe shtesat (bonifications) e pleqërisë që llogariten në funksion të një përqindjeje të përcaktuar prej moshës së personit të interesuar, sipas rregullit "rroga e bashkërenduar x përqindjen sipas moshës". Kjo e fundit është 18%⁴⁶ për personat nga 55 deri në 64 vjeç për gratë, 65 vjeç për burrat.

Vladimiri është 59 vjeç dhe ka një rrogë të bashkërenduar prej CHF 38'500.-/vit. Shte-

sa e pleqërisë për të do të jetë 38'500.- x 18% = 6'930.- për vitin përkatës.

Pensionit i pleqërisë llogaritet duke shumëzuar kapitalin e pleqërisë të të siguruarit.ës në momentin e daljes në pension (në moshën e pensionit, të parakohshëm apo të shtyrë) me një përqindje të qatjur kthim (conversion), që sot është 6,8%.

Në moshën 65 vjeç, Xhianluka ka një kapital pleqërie prej CHF 135'000.- pranë arkës së tij të pensionit. $135'000.- \times 6,8\% = 9'180.-$ /vit, gjë që përfaqëson një pension mujor prej CHF 765.-

Shembujt me shifra të mësipërm rrjedhin prej dispozitave ligjore të LPP-së; por, sidoqoftë, e besueshme është vetëm rregullorja e arkës së pensionit të të siguruarit.ës.

b) Pension ose pension/kapital

Ndërsa në kuadrin e shtyllës së 1rë (LAVS) parashikohet që kur ndodh "rreziku" i pleqërisë, të mund të përfitohet vetëm pension mujor, në kuadrin e shtyllës së 2të (LPP) ekzistojnë mundësitë

- për të kërkuar vetëm pension mujor, që jepet deri në vdekjen e të siguruarit.ës
- për të marrë një pjesë të shumës në formë kapitali dhe për të përfituar njëkohësisht pension mujor, i cili do të jetë më pak i lartë për shkak të tërheqjes të pjesëshme në formë kapitali.



Rregullorja e çdo arke përcakton kushtet në të cilat derdhja e kapitalit është e mundur, ndërsa ligji kërkon që i.e siguruari.a të ketë sidoqoftë mundësinë për të kërkuar që një e katërta e kapitalit të tij të pleqërisë t'i derdhet në formë kapitali⁴⁷.

Çdo i.e siguruar duhet të përcaktojë nëse derdhja në formë kapitali e një pjese të shumës është e përshtatshme apo jo për të: për këtë, ai duhet të mbajë parasysh pikërisht projektet e veta dhe të familjes për të ardhmen, shumën mujore të pensionit që mund të përfitojë paskëtaj, derdhjen e mundshme në kuadrin e shtyllës së 3të (shih faqen 31).

Pensionit i shtyllës së 1rë (LAVS) llogaritet në bazë të të drejtave të çiftit të martuar (shih faqen 15), ndërsa ai i shtyllës së 2të (LPP) është vetjak dhe nuk ndikohet prej të drejtave të mundshme të bashkëshortit ndaj arkës së vet të pensioneve.

Mercedesi dhe Mariusi që të dy dalin në pension në shtator 2023.

Mercedesi përfiton një pension të shtyllës së 1rë (LAVS) prej CHF 1'650./muaj.

Mariusi përfiton një pension të shtyllës së 1rë (LAVS) prej CHF 1'872./muaj, gjë që përfaqëson një shumë të përgjithshme prej CHF 3'522./muaj.

Duke qenë se shumata e përgjithshme nuk i

kalon CHF 3'525./muaj (150 % të pensionit më të lartë prej CHF 2'350.-), këto dy pensione të shtyllës së 1rë (LAVS) nuk do të pësojnë asnjë pakësim, shih faqen 15).

Mercedesi përfiton një pension të shtyllës së 2të (LPP) prej CHF 1'822./muaj.

Mariusi përfiton një pension të shtyllës së 2të (LPP) prej CHF 1'978./muaj, gjë që përfaqëson një shumë të përgjithshme prej CHF 3'800./muaj.

Pavarësisht prej shumës së pensionit që do të përfitojë secili prej bashkëshortëve në kuadrin e shtyllës së 2të (LPP), nuk do të bëhet asnjë pakësim, duke qenë se secili prej tyre ka të drejtën e vet të mirëfilltë për pension.

c) Pensioni për fëmijë⁴⁸

Përfituesit e pensionit të pleqërisë kanë të drejtë edhe për pension plotësues për çdo fëmijë nën moshën 18 vjeç, e deri në 25 vjeç në rast fromimi apo studimesh.

Ky pension përkon me 20%⁴⁹ të atij që përfiton i.e siguruari.a.

Në nëntor 2017, në përfundim të karrierës së vet profesionale, Elena kishte një kapital pleqërie pranë arkës së pensionit (shtylla e 2të, LPP) prej CHF 88.124,35.

Ajo mund të përfitojë një pension prej CHF 5'992.45/vit, apo CHF 499.35/muaj. Ky



47 Neni 37 par.
2 LPP

48 Neni 17 LPP

49 Neni 17 par.
1 LPP, neni 21 par.
1 LPP

pension i shtyllës së 2të plotëson atë të shtyllës së 1rë (LAVS).

Po ashtu, për djalin e vet, 23 vjeç që është student në universitetin e Lozanës, ajo do të përfitojë një pension prej CHF 99.85/ muaj, e shumta deri sa ai të ketë mbushur moshën 25 vjeç edhe sikur të mos e ketë përfunduar ende formimin e tij .



Shtylla e parë dhe e dytë shkurtimisht

1. Parimi

Pensionet e pleqërisë të derdhura në kuadrin e shtyllës së 1rë (LAVS) e të 2të (LPP) duhet të arrijnë në rreth 60% të të ardhurave që kishte i.e siguruari.a para daljes në pension.

2. Për sa u përket afateve kohore

Pak rëndësi ka nëse i.e siguruari.a vendos të dalë në pension të parakohshëm, ta shtyjë daljen në pension apo të dalë në pension në moshën e caktuar. E nevojshme është që ai të kontaktojë, nëse është rrogëtar përmes punëdhënësit,

- arkën e kompensimit në të cilën ka hyrë punëdhënësi (pension pleqërie i shtyllës së 1rë, LAVS)
- arkën e pensionit të punëdhënësit (pension pleqërie i shtyllës së 2të, LPP).

Në fakt, siguruasi i shtyllës së 1rë (LAVS) dhe ai i shtyllës së 2të (LPP) nuk mund ta dinë momentin e zgjedhur prej të siguarit.ës për të dalë në pension, prandaj ata nuk do të bëjnë asnjë derdhje pensioni, nëse nuk është bërë kërkesë paraprakisht, mundësisht gjashtë muaj para datës së caktuar për daljen në pension.

Përçapjet lidhur me shtyllën e 1rë (LAVS) dhe të 2të (LPP), rrogëtarët do t'i kryejnë përmes punëdhënësit.ve të tyre, ndërsa të pavarurit.at dhe personat pa veprimtari fitimprurëse përmes formularit 318.370 ("kërkesë për pension pleqërie") që gjendet pranë shërbimit të sigurimeve shoqërore (SAS) të Lozanës (shih kapitullin 9, f.47).

3. Ndhimat plotësuese të pensionit të shtyllës së parë (LPC për AVS-në)

Mund të ndodhë që të ardhurat tashmë të përfituara në formë pensioni të mos jenë të mjaftueshme për të mbuluar nevojat e zakonshme, megjithë administrimin e rreptë të buxhetit mujor: në një rast të tillë do të jetë e nevojshme që të kërkohen ndihmat plotësuese (LPC për AVS-në, shih faqen 27).


4. Shtylla e tretë (LCA)

Pra, pensionet e shtyllës së 1rë (LAVS) dhe shtyllës së 2të (LPP) nuk i mundësojnë të siguruarit.ës garantimin e të njëjtave mjete financiare si gjatë kohës kur ai/ajo ushtron-te një veprimtari fitimprurëse: në fakt, sistemi helvetik parashikon krijimin prej të siguararve.ave të një parashikimi privat (prévoyance privée), të quajtur “shtylla e 3të” (LCA, shih faqen 31), gjatë tërë jetës e deri në daljen e tyre në pension. Ky parashikim, ndryshe nga shtylla e 1rë (LAVS) dhe shtylla e 2të (LPP) nuk është i detyrueshëm; ai mbetet i varur prej mjeteve financiare që zotëron secili gjatë rrugëtimit të vet profesional e vetjak.



4.

**Ndihmat plotësuese të
pensionit të shtyllës së
parë** (LPC për AVS-në)



1. Parimi

Kur përfitimet e mara nga një apo disa sigurues dhe pasuria nuk mjaftojnë për përballimin e shpenzimeve bazë (nevojat jetësore) mund të kërkojen ato që quhen ndihma plotësuese (LPC) të pensionit të pleqërisë, të të mbijetuarve apo të invaliditetit pranë agjencisë të sigurimeve shoqërore të vendit të banimit: neni 12 i Kushtetutës federale garanton në fakt të drejtën themelore për të marrë “mjete të domosdoshme për një jetë në përputhje me dinjitetin njerëzor”.

Përcaktimi i të drejtës për ndihmat plotësuese bëhet në bazë të një llogaritjeje krahasuese: shihet se cilat janë të ardhurat përcaktuese (pensionet, të ardhurat nga pasuria, vlera qiradhënëse) pastaj ato krahasohen me shpenzimet e njohura me ligj.

Të ardhurat e një personi përbëhen sidomos nga

- pensionet e ndryshme
- të ardhurat nga pasuria e tundshme dhe e patundshme (siç janë të ardhurat nga qiradhënia për pronarët e banesave)
- një e dhjeta e pasurisë që e kalon shumën CHF 37'500.- për një person të vetëm dhe CHF 60'000.- për një çift⁵⁰.

Shpenzimet e njohura janë

- shuma e paracaktuar për nevojat jetësore, pikërisht CHF 19'290.-/vit për një person të vetëm (CHF 1'607.50/muaj), CHF 28'935.-/vit për një çift

(CHF 2'411.25/muaj), për mbulimin e shpenzimeve të ushqimit, për blerjen e veshjeve, për mobiliet, telefonin, tatimet dhe taksat

- qiraja vjetore bruto e banesës dhe shpenzimet anësore⁵¹.

2. Kushtet

Ndihmat plotësuese jepen me kusht që

- personi kërkues të jetë me banim në Zvicër, qysh prej 10 vjetësh e kjo në mënyrë të pandërprerë, nëse ai nuk është zviceran apo shtetas i një vendi anëtar të Bashkimit evropian (UE) apo të Shoqatës europiane të shkëmbimit të lirë (AELE)⁵².

3. Përfitimet

Ndihmat plotësuese përfshijnë dy tipe ndihmash

- **ndihmën plotësuese vjetore (e cila megjithatë derdhet çdo muaj⁵³)**, e drejta për të cilën, në parim, lind që ditën e parë të muajit në të cilin dorëzohet kërkesa⁵⁴; nëse kërkesa dorëzohet brenda gjashtë muajve pas pranimit në një institucion mediko-sho-



50 Neni 11 par. 1 lit a deri te d LPC

51 E shumta një shumë prej CHF 13'200.-/ vit për një pranohet për një person të vetëm dhe prej CHF 15'000.-/ vit për një për një çift.

52 Neni 5 LPC

53 Neni 9ss LPC

54 Neni 12 par. 1 LPC

qëror (EMS), e drejta lind që ditën e parë të muajit në të cilin është bërë hyrja në EMS.

• **rimbursimi i shpenzimeve mjeksore dhe invalidore**⁵⁵: shpenzimet mjeksore dhe invalidore mund të rimbursohen nga ndihmat plotësuese, po që se ato nuk mbulojnë nga një sigurim tjetër (LAMal). Të siguruarve.ave përfitues.e të ndihmave plotësuese mund t'u rimbursohen pikërisht shpenzimet për trajtimin e dhëmbëve, me kusht që ai të jetë i thjeshtë, ekonomik dhe i përshtatshëm, shpenzimet për përkujdesjen dhe ndihmën në banesë, shpenzimet e transportit deri në vendin e përkujdesjes shëndetësore më të afërt, shpenzimet që rrjedhin nga mjetet ndihmëse, shumën e frankizës (franchise) dhe kuotën e pjesëmarrjes në shpenzimet (quote-part) e sigurimit mjeksor (LAMal), tavani i të cilave është CHF 1'000.-/vit, gjë që përfshin frankizën më të ulët (CHF 300.-/vit për një të rritur) si dhe kuotën më të lartë të pjesëmarrjes në shpenzime (CHF 700.-/vit).

Shpenzimet mjeksore mund të rimbursohen edhe nëse nuk jepet asnjë ndihmë plotësuese vjetore, kur këto shpenzime janë më të larta se shumata e tepricës të të ardhurave të personit të interesuar, ashtu siç përcaktohet në llogaritjen e të drejtës së tij për ndihmat plotësuese (LPC për AVS-në).

Buxheti i Zhozeas, 79 vjeç, tregon një tepricë të ardhurash prej CHF 1'200.-/muaj në bazë të llogaritjes së ndihmave plotësuese.

Ajo nuk mund të pretendojë pra për marrjen e ndihmave plotësuese të pensionit të saj të shtyllës së parë (LAVS).

Në janar, asaj i duhet të shkojë te dentisti, i cili do të kryejë shumë ndërhyrje, me qëllim që ajo të ketë mundësi të hajë përsëri ashtu siç duhet.

Fatura e mjekut është CHF 2'600.- ; teprica e të ardhurave CHF 1'200.- nuk i lejon asaj që ta përballojë e vetme këtë shpenzim: ajo mund të kërkojë rimbursim për 2'600.- - 1'200 = CHF 1'400.- pranë agjencisë komonale të sigurimeve shoqërore (shih kapitullin 9, f.47).

Përfituesit.et e ndihmave plotësuese për AVS-në mund të lirohen nga pagesa e taksës së radios dhe televizionit: për ta bërë këtë, u rekomandohet që t'i dërgojnë një kërkesë për lirim nga taksa organit të arkëtimit Billag SA (shih adresat në shtojcë) në momentin e dorëzimit të kërkesës fillestare për ndihmat plotësuese.

Zhozea, 81 vjeç, qysh nga 1 marsi jeton në EMS, sepse shëndeti nuk ia lejon më qëndrimin e vetme në banesë. Pensionet e saj të pleqërisë prej CHF 2'625.- dhe pasuria vetjake nuk mjaftojnë për të mbuluar shpenimet që lidhen me këtë vend të ri jetese.

Ajo mund të bëjë kërkesë për ndihma plotësuese pranë agjencisë komunale të sigu-



rimeve shoqërore para fundit të gushtit: nëse kërkesa e saj pranohet, ndihmat do t'i derdhen, në mënyrë prapavepruese, qysh nga 1 marsi.

Ndodh relativisht shpesh që një person në pension, me përparimin e moshës, në një moment të dhënë, të ketë nevojë për ndihmë për kryerjen e veprimeve të jetës të përditshme: kështu që të pastrohet, të vishet e zhvishet, të lëvizë e të hajë ai ka nevojë të mbështetet nga një person i tretë. Në këtë rast, flitet për pafuqi.

Rregulla të veçanta zbatohen atëherë në këto raste⁵⁶: informacione të sakta mund të merren për këtë pikërisht pranë shërbimit shoqëror të Pro Senectute-s (shih kapitullin 9, f.47), siti internet i së cilës ka edhe një llogaritës me anën e të të cilit mund të verifikohet nëse ka gjasa të ekzistojë apo jo një e drejtë për për të marë ndihma plotësuese (LPC) .




56 Neni19b ss
OPC

5.

Pensioni në kuadrin e shtyllës së tretë

(troisième pilier-LCA)



1. Parimi

Në bazë të nenit 111 paragrafi 1 të Kushtetutës federale, parapërgatitja e mbrojtjes nga rreziqet që lidhen me pleqërinë, të mbi-jetuarit dhe invaliditetin duhet të kalojë edhe përmes një parashikimi individual.

Pensioni i pleqërisë i shtyllës së 1rë (LAVS) synon të garantojë mbulimin e nevojave jetësore, ai i shtyllës së 2të (LPP) ka për objektiv të ruajë të njëjtin nivel jetese si para daljes në pension.

Qëllimi i shtyllës së 3të(LCA) është që, në moshën e daljes në pension, të mbulojë nevojat vetjake, gjë që sidoqoftë është e mundur vetëm po qe se dhe në atë masë që personi i interesuar ka pasur mjete financiare të mjaftueshme për të krijuar një “rezervë” gjatë tërë jetës së tij.

2. Format e parashikimit individual

Ky parashikim vetjak mund të mvëshë shumë forma: kursime të depozituara në një llogari bankare apo postare, investime në bursë, mbyllje e një kontrate sigurimi, që shpesh quhet “sigurim-jete”.

Ky sigurim i takon të drejtës private dhe është i veçantë për çdo kompani sigurimi; të mbajmë në kujtesë se ekzistojnë dy tipe sigurimi:

a) sigurimi parashikim individual i shtyllës së 3të a, i quajtur “parashikim i lidhur”, i cili mbulon tri rreziqet që janë pleqëria, humbja e mbështetjes (të mbijetuarit) dhe invaliditeti: shuma e kuotizacioneve mujore caktohet prej marrësit të sigurimit, në funksion të mjeteve të tij financiare. Këto derdhje, që mund të zbriten prej të ardhurave të taksueshme⁵⁷ fiskalisht, mund të arrijnë deri në

- CHF 6'768.-/vit për rrogëtarët e siguruar edhe prej një arke pensioni në kuadrin e shtyllës së 2të (LPP)

- 20% të të ardhurave të një të pavaruri.e, e shumta CHF 33'840.-/vit⁵⁸.

Personat që nuk ushtrojnë veprimtari fitimprurëse nuk mund të krijojnë një mbulesë në kuptimin e shtyllës së 3të a.

b) sigurimi parashikim individual shtylla e 3të b, i quajtur “parashikim i lirë”: ai mbulon në përgjithësi rreziqet e vdekjes (humbje e mbështetjes) dhe invaliditetin, por mund të parashikohet megjithatë edhe një pjesë “pleqëri”; kontributet mujore nuk mund të zbriten nga të ardhurat e taksueshme fiskalisht. Ky sigurim është i hapur për çdo njeri, që ushtron apo jo veprimtari fitimprurëse.




57 Neni 33 par. 1 lit e LIFD, neni 37 par. 1 lit e LI (RSV 642.11)

58 Neni 7 par. 1 lit b OPP3, neni 8 par. 1 LPP

3. Përfitimet

Në moshën e caktuar me marrëveshje me kompaninë e sigurimit që administrojnë shtyllën e 3të (LCA), marrësi apo marrësja e sigurimit përfiton nga derdhja e një kapitali (shumë rrallë ndodh që një shtyllë e tretë të ketë për objektiv derdhjen e pensioneve mujore), shuma e të cilit do të përcaktohet nga përmasa e kontributeve vjetore të derdhura si dhe nga kohëzgjatja e tyre.

Fjala është që të parashikohet me kujdes se cila do të jetë shuma mujore që i.e siguruari.a dëshiron të përdorë kur të arrijë në moshën e pensionit apo nëse ai/ajo mendon që tërë kapitalin ta përdorë për një projekt të veçantë, siç është pikërisht rimbursimi i një kredie hipotekare apo blerja e një apartamenti.



6.

Aspektet fiskale në moshën e pensionit



1. Pensionet

Pensionet e përfituara në kuadrin e shtyllës së 1rë, të 2të dhe, me shumë gjasa, të 3të (LAVS, LPP, LCA) duhet të deklarohen çdo vit në kuadrin e deklaratës së tatimeve⁵⁹: të qenët në pension nuk i ndryshon detyrimet fiskale⁶⁰.

Këto pensione quhen “të ardhura”⁶¹ në kuptimin e ligjeve fiskale, si federale edhe kantonale.

Vetëm ndihmat plotësuese (LPC) nuk quhen të ardhura⁶².

2. Kapitali

Kur i.e siguruari.a zgjedh që një pjesë të kapitalit të tij të shtyllës së 2të (LPP) dhe të shtyllës së 3të (LCA) ta marrë në formë kapitali, shuma e përfituar do të jetë gjithashtu objekt i një tatimi të veçantë e të vetëm, me përqindje dhe kushte të ndryshme nga ato që kanë të bëjnë me të ardhurat.

Shtylla e 3të 3a

Baptisti, në moshën 65 vjeç, veç pensione-ve që rrjedhin nga shtylla e 1rë (LAVS) dhe shtylla e 2të (LPP), merr edhe një kapital prej CHF 100'000.- që rrjedh nga një kontratë sigurimi parashikim i lidhur 3a (shih faqen 31) që kishte bërë që në fillim të veprimtarisë së tij profesionale.

Ai do të duhet ta deklarojë fiskalisht këtë shumë, e cila do t'i nënshtrohet tatimit sipas një shkalle të përcaktuar nga Konfederata, kantoni dhe komuna e vendit të banimit; në mënyrë treguese, mund të konsiderojmë se autoritetet fiscale do të vënë një tatim të vetëm prej rreth 9 %.

Shtylla e 3të 3b

Shuma e përfituar në kuadrin e një kontrate sigurimi parashikim 3b (shih faqen 31) nuk do të tatóhet, meqenëse, gjatë krijimit të saj, kontributet nuk janë zbritur prej të ardhurave në kuptimin fiskal dhe ajo është tatuar si pasuri, deri në daljen në pension.

AVIVO-ja është një shoqatë që propozon pikërisht një shërbim të përhershëm informimi shoqëror dhe ndihmë për plotësimin e deklaratës së tatimeve (shih kapitullin 9, f.47).



59 Neni 22 par. 1 LIFD

60 Neni 8 par. 2 LIFD

61 Neni 16 par. 1 LIFD dhe 23 lit a LIFD

62 Neni 24 lit h LIFD

7.

**Largimi nga Zvicra në
moshën e pensionit**



1. Hyrje

Persona të shumtë, pasi mbushin moshën e pensionit, dëshirojnë të largohen nga Zvicra, në përgjithësi për t'u kthyer të jetojnë në vendet e tyre të origjinës, me gjasë në vende ku kostoja e jetesës është më e ulët se në Zvicër.

Vendimi për t'u larguar përfundimisht nga Zvicra, duhet të mendohet mirë, duke mbajtur parasysh pikërisht gjendjen e vet shëndetësore, kushtet e jetesës në vendin ku synohet të shkohet, qendrueshmërinë politike, madje edhe praninë apo mungesën e një rrethi miqsh, në atë vend.

2. Eksportimi i përfitimeve të mara nga sigurimet

Atëherë lind çështja e “eksportueshmërisë” të përfitimeve, qoftë të atyre të shtyllës së 1rë (LAVS), të shtyllës së 2të (LPP) apo të shtyllës së 3të (LCA). Në fakt, disa përfitime që rrjedhin nga e drejta zvicerane mund të derdhen edhe jashtë, përkundrazi disa të tjera i nënshtrohen kushtit të banimit në Zvicër.

a) Shtylla e parë (LAVS)

- **pensionit:** është i eksportueshëm për në vendet anëtare të Bashkimit europain (UE) të Shoqatës europiane të shkëmbimit të lirë (AELE) dhe për në Australi, San-Marino, Kanada, Izrael, Japoni, Turqi, Kili, Ma-

qedoni, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kroaci, Filipine, Bosnjë-Herzegovinë, Serbi, Mali i Zi dhe Uruguaj. Përkundrazi, pensioni nuk mund të derdhet në vendet e tjera dhe e drejta e përfitimit të tij shuhet, kur i.e siguruari.a heq dorë nga banimi në Zvicër

- **ndihmat plotësuese** të pensionit të pleqërisë, **alokacionet për pafuqi** si dhe **mjetet ndihmëse** varen nga vendi i banimit të të siguruarit.ës, që i humbet këto të drejta, në rast largimi përfundimisht jashtë vendit: vetëm qëndrimet jashtë për më pak se tre muaj në vit lejojnë mbajtjen e këtyre përfitimeve.

Vanesa, pensioniste 71 vjeç, është përfituese e ndihmave plotësuese (LPC) qysh nga mosha 65 vjeç. Çdo vit, në muajin shtator, ajo kalon tri javë pranë familjes së saj në Ukrainë, në breg të Detit të Zi, dhe për festat e fundvitit shkon në Kiev.

Këto dy qëndrime të shkurtra nuk e çënojnë të drejtën e saj për ndihmat plotësuese, meqënëse ajo nuk është e pranishme në Zvicër vetëm një muaj në vit.

b) Shtylla e dytë (LPP)

Pensionit i pleqërisë i shtyllës së 2të (LPP) mund të derdhet në çdo vend të botës dhe për këtë qëllim përçapjet duhet të bëhen pranë arkës së pensioneve kompetente, pikërisht pranë arkës së fundit ku ka qenë i siguruar personi që ka dalë në pension.



c) Shtylla e tretë (LCA)

Përfitimet e shtyllës së 3të janë të eksportueshme; për këtë duhet të merret kontakt me siguruesin, i cili në moshën e caktuar do të japë përfitimet për të cilat është bërë marrëveshje.

d) Ndikimi në lejen e qëndrimit të Zvicër

Largimi nga Zvicra duhet të jetë një veprim i menduar mirë, meqenëse një kthim i mundshëm më vonë, në kanotin e Vaudit apo në një pjesë tjetër të Zvicrës, mund të ketë për pasojë ndërmarrjen e përçapjeve të reja për marrjen e një lejeje qëndrimi të re, të cilat përcaktohen nga shtetësia e kërkuesit dhe nga kohëzgjatja e qëndrimit jashtë Zvicrës. Në fakt, leja e qëndrimit C (ngulimi) nuk është më e vlefshme, kur personi largohet nga territori zviceran për më shumë se 4 vjet. Shërbimi i kontrollit të banorëve i Lozanës (shih kapitullin 9, f.47) është në dispozicion për më shumë informacione lidhur me lejet e qëndrimit. Ndihmë mund të merret edhe pranë shoqatës Fraternité (Vëllazëria) (Shih kapitullin 9, f.47)



Po “nesër” ?

Zvicra është në kërkim të zgjidhjeve për të siguruar vazhdimësinë e sistemit të saj të pensioneve. Sidoqoftë, të gjitha modifikimet e paraqitura, në këtë kontekst, për votim popullor, janë hedhur poshtë:

- maj 2004: hedhje poshtë e ndryshimit të 11të të AVS-së, i cili parashikonte uljen e përfitimeve dhe mospranimin e ngritjes të TVSH-së (TVA) në favor të AVS-së dhe AI-së,
- mars 2010: hedhje poshtë e uljes së përqindjes në kuadrin e shtyllës së 2të (LPP),
- shtator 2017: hedhje poshtë e projektit “parashikimi i pleqërisë 2020” dhe rritja e taksës së vlerës të shtuar (TVA) në favor të AVS-së.

Sidoqoftë, pikërisht për arsye të zgjatjes së shpresës të jetës të popullsisë si dhe mplakjes së saj si dhe dobësisë së rendimenteve të tregut financiar, që ndikojnë mbi kapitalin e shtyllës së dytë, ndryshimet legjislative të sistemit helvetik të pensioneve do të jenë të pashmangshme në vitet që do të vijjnë.

Në fakt, do të shtrohet çështja

- a)** e financimit të tij afatmesëm dhe afatgjatë,
- b)** e nivelit të pensioneve, si dhe ajo
- c)** e moshës së daljes në pension, duke qenë se ndryshimi midis grave dhe burrave

(64/65 vjeç) tashmë është venë në pikëpyetje në mjedise të ndryshme politike.

Nuk është e mundur të merret me mend sot se çfarë ndikimesh do të mund të kenë këto ndryshime mbi pensionet e tanishme dhe ato që do të derdhen së afërmi: do të duhet pra që në momentin e duhur të informoheni pranë organizmave përkatëse, në veçanti pranë arkave të kompensimit të shtyllës së 1rë (LAVS) dhe arkave të pensioneve të shtyllës së dytë (LPP).



8.

**Ndihmat për të
moshuarit në Lozanë
dhe në kantonin e
Vaudit**



Ky kapitull, që i kushtohet disa fushave të përzgjedhura, ofron një shikim të përfitimeve bazë për personat në pension. Çdo fushë përmban një përshkrim të shkurtër të përfitimeve ekzistuese, informacione praktike, si dhe një përzgjedhje adresash që ju mundësojnë gjetjen e bashkëbiseduesve që janë në gjendje për t'ju dhënë shpjegime dhe informacione plotësuese të nevojshme. Përfitimet e propozuara nuk janë shteruese dhe mbeten të ndryshueshme.

Informacione të përgjithshme - përfitime të ndryshme

Pro Senectute

Pro Senectute-ja është një shoqatë private me dobi publike, që gëzon mbështetjen e pushteteve publike dhe vepron në të gjithë Zvicrën. Qëllimi i saj është që të kontribuojë në mirëqënien materiale, fizike dhe morale të të moshuarve, si dhe në ruajtjen dhe forcimin e aftësisë së tyre për të pasur njëkohësisht një jetë të pavarur, por edhe të ndër-futur në shoqëri.

Përfitimet:

- Konsultore shoqërore për të moshuarit
- Point Info-seniors (Pika Info-Të Moshuarit)
- Argëtime dhe takime për të moshuarit
- Sport dhe mirëqënie për të moshuarit
- Punë vullnetare në favor të të moshuarve
- Kurse anglishteje për të moshuarit
- Kurse informatike për të moshuarit

- Kurs përgatitor për daljen në pension dhe për të moshuarit në papunësi

Pro Senectute Vaud

Rue du Maupas 51

1004 Lausanne

Tel. 021 646 17 21

info@vd.prosenectute.ch

www.vd.prosenectute.ch

Orari: e Hënë -e Premte, ora 8.15-12h, 13.30-16.30

AVIVO

AVIVO-ja është një shoqatë për mbrojtjen dhe çlodhjen e pensionistëve, e krijuar më 1948 dhe vepruese në kantonin e Vaudit. Seksioni i saj lozanez numëron rreth 3'000 anëtarë

Përfitimet:

- Mbrojtja e të drejtave të pensionistëve, në mënyrë individuale dhe kolektive.
- Ndihmë për plotësimin e deklaratave të tatimeve.
- Shërbimi shoqëror
- Veprimtari argëtuese

AVIVO

Place Chauderon 3

1003 Lausanne

Tel. 021 312 06 54

info@avivolausanne.ch

www.avivo-vaud.ch

Orari: e Hënë, e Martë, e Enjte, e Premte, ora 9-12 dhe 14-17



Informim - përgatitje për daljen në pension

Nëse jeni në pension apo dëshironi të përgatiteni për këtë gjë, shërbime të ndryshme mund t'ju përgjigjen pyetjeve tuaja.

Zyra lozaneze për të imigruarit (Le Bureau lausannois pour les immigrés) propozon fa-las atelie përgatitore për daljen në pension për personat e migruar. Gjatë këtyre takimeve, jepen informacione të dobishme mbi përçapjet, çështjet juridike dhe administrative, si dhe mbi zgjedhjet që mund të bëhen para daljes në pension. Temat si AVS-ja, shtylla e dytë, marrëveshjet dypalëshe, madje edhe çështjet fiskale trajtohen gjatë këtyre atelieve.

Në Point Info Seniors (Pika Info-Të Moshuarit), shërbimi shoqëror i Pro Senectute-s, një bashkëpunëto-re me përvojë dëgjon, u përgjigjet të gjitha pyetjeve në lidhje me daljen në pension dhe i orienton të moshuarit dhe të afërmit e tyre drejt shërbimeve të duhura.

Programi AvantAge, i krijuar nga Pro Senectute-ja, propozon nga ana e tij një mbështetje prej eksperti në parashikimin dhe përgatitjen e daljes në pension në kushte sa më të mira, si dhe në favorizimin e punësueshmërisë së të moshuarve.

Ateliers de préparation à la retraite pour personnes migrantes (Atelie përgatitore për daljen në pension për personat e mërguar) Bureau lausannois pour les immigrés - BLI (Zyra lozaneze për të imigruarit)

Place de la Riponne 10 - CP 5032

1002 Lausanne

Tel. 021 315 72 45

bli@lausanne.ch

www.lausanne.ch/bli

Orari: e Hënë-e Premte, ora 8-12, 13-17

Point Info-seniors (Pika Info-Të Moshuarit)

Espace Riponne (Hapësira Riponë)

Place de la Riponne 5

1005 Lausanne

Tel. 021 641 70 70

info-seniors@vd.prosenectute.ch

<https://vd.prosenectute.ch/fr>

> Conseil > Point Info-seniors

Orari: e Hënë, e Martë, e Enjte, ora 9-12, 13.30-16 ose me takim

Programme AvantAge: anticiper et préparer sa retraite (Programi AvantAge: parashikimi dhe përgatitja e daljes në pension)

AvantAge

Rue du Maupas 51

1004 Lausanne

Tel. 021 711 05 24

info.fr@avantage.ch

www.avantage.ch

Orari: e Hënë-e Premte, ora 8.15-12, 13.30-16.30

Agëtime - Formime

Shoqata Mouvement des aînés Vaud (Lëvizja e të moshuarve Vaud) u propozon personave në pension dhe parapensionistëve veprimtari të organizuara kryesisht nga vullnetarë në fushat më të larmishme: takime, ekskursionet, argëtime, formime, mirëqënie, udhëtime, punë vullnetare.

E krijuar me një perspektivë të formimit të vazhdueshëm përgjatë tërë jetës, Connnaissance 3 (Njohuria 3) është Universiteti i të moshuarve i kantonit të Vaudit. Programi i saj i konferencave, kurseve, seminareve, atelieve dhe vizitave kulturore/shkencore u drejtohet me përparësi të moshuarve, por ajo është e hapur për të gjitha dhe të gjithë, pa kufizim moshe e pa marrë parasysh diplomën.

Mouvement des aînés Vaud (Lëvizja e të moshuarve Vaud)

Place de la Riponne 5
1005 Lausanne

Tel. 021 320 12 62

secretariat@mda-vaud.ch

www.mda-vaud.ch

Orari: e Hënë-e Premte, ora 8-12 dhe 13.30-17.

Université des seniors (Universiteti i të moshuarve) / Connnaissance 3 (Njohuria 3)

Place de la Riponne 5

1005 Lausanne

Tel. 021 311 46 87

info@connnaissance3.ch

www.connnaissance3.ch

Orari: e Hënë-e Premte, 8.45-12

Strehimi - Shëndeti

Shërbimi i sigurimeve shoqërore dhe strehimit (Service des assurances sociales et de l'hébergement-SASH) u vjen në ndihmë të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara dhe rrethit të tyre, përmes marrjes dhe vënies në jetë të masave të ndihmës e të mbështetjes individuale apo kolektive, në banesë apo në mjedis institucional. Ai është i ngarkuar me nxitjen dhe bashkërendimin e masave shoqërore të ndihmës e mbështetjes për të mundësuar qëndrimin e të moshuarve në banesë.

Service des Assurances Sociales et de l'Hébergement - SASH (Shërbimi i sigurimeve shoqërore dhe strehimit)

Avenue des Casernes 2

Bâtiment administratif de la Pontaise

1014 Lausanne

Tel. 021 316 51 51

info.sash@vd.ch

www.vd.ch/vivre-a-domicile

Orari: e Hënë-e Premte, ora 8-12, 14-17



Aftësitë e kufizuara

Lozana ofron përfitime të shumta shoqërore, sanitare dhe mjekesoro-shoqërore. Një listë e përfitimeve zyrtare apo private gjendet në sitin e internetit të mëposhtëm: www.lausanne.ch/aineshandicapes

Për shembull, në treguesin T, Transportet, do të gjeni të gjitha ndihmat e mundshme për zhvendosjet tuaja në rast lëvizshmërie të kufizuar.

Service des assurances sociales (Shërbimi i sigurimeve shoqërore)

Place Chauderon 7, 1er étage

1002 Lausanne

Tel. 021 315 11 11

sas@lausanne.ch

www.lausanne.ch/aineshandicapes

Orari: e Hënë-e Premte, ora 8.30-11.45, 13-17

Sigurimet dhe aspektet juridike

Shërbimi i sigurimeve shoqërore, me agjencinë e vet të sigurimeve shoqërore, informon dhe shoqëron popullsinë në përçapjet administrative që lidhen me degët e sigurimeve AVS/AI si dhe në fushat e ndihmave plotësuese për AVS/AI-së dhe rimbursimet e shpenzimeve shëndetsore, alokacionet familiare dhe kërkesat e ndihmës (subside) për sigurimin bazë të sëmundjeve, si dhe ndihmat plotësuese për familjet dhe pensionin-urë të AVS-së.

Arkat e kompensimit, në cilësinë e organeve zbatuese të sigurimit shoqëror zbatojnë detyrat e lidhura me sigurimin e pleqërisë dhe të mbijetuarve.

Service des assurances sociales (Shërbimi i sigurimeve shoqërore)

Place Chauderon 7, 1er étage

1002 Lausanne

Tel. 021 315 11 11

sas@lausanne.ch

www.lausanne.ch/assurances-sociales

Orari: e Hënë-e Premte, ora 8.30-11.45, 13-17

Caisse cantonale vaudoise de compensation (Arka kantonale vaudeze e kompensimit)

Rue des Moulins 3

1800 Vevey

Tel. 021 964 12 11

avs.vaud@avs22.ch


www.caisseavsvaud.ch

Orari: e Hënë-e Premte, ora 8-12, 13.30-16



9.

**Adresa të dobishme
sipas rendit alfabetik**



A

Agence d'assurances sociales (SAS) (Agjencia e sigurimeve shoqërore),
Service des assurances sociales (shërbimi i sigurimeve shoqërore) në Lozanë
Place Chauderon 7
1002 Lausanne
tél. 021 315 11 11
www.lausanne.ch/assurances-sociales

AVIVO

Place Chauderon 3
1003 Lausanne
tél. 021 312 06 54
www.avivo-vaud.ch

B

Billag SA
Case postale
1701 Fribourg
tel. 0844 834 834
www.billag.ch

Bureau lausannois pour les immigrés-BLI (Zyra lozaneze për të imigruarit)

Place de la Riponne 10
Case postale 5032
1002 Lausanne
tél. 021 315 72 45
www.lausanne.ch/bl

C

Caisse cantonale vaudoise de compensation (Arka kantonale vaudeze e kompensimit)
Rue des Moulins 3
1800 Vevey
tél. 021 964 12 11
www.caisseavsvaud.ch

Caisse suisse de compensation (CSC) (Arka zvicerane e kompensimit)
Avenue Edmond-Vaucher 18
Case postale 3100
1211 Genève 2
tél. 058 461 91 11
www.ahv-iv.ch/fr/Contacts/
ou www.zas.admin.ch

Centre régional de décisions rente-pont (Qendra rajonale e vendimeve te pensionit-ure)
Place Chauderon 7
1002 Lausanne
tél. 021 315 11 11
www.lausanne.ch/assurances-sociales

Contrôle des habitants (Kontrolli i banorëve)
Rue du Port-Franc 18
Case postale 5354
1002 Lausanne
tél. 021 315 31 33
www.lausanne.ch/ch

F

Fraternité (Vëllazëria) (Centre social protestant, CSP / Qendra shoqërore protestante)
Place Arlaud 2
1003 Lausanne
tél. 021 213 03 53
www.csp.ch

H

Handicap (Aftësitë e kufizuarra), **service des assurances sociales** (shërbimi i sigurimeve shoqërore)
Place Chauderon 7
1002 Lausanne
tél. 021 315 11 11
www.lausanne.ch/assurances-sociales

M

Mouvement des aînés Vaud (Lëvizja e të moshuarve Vaud)
Place de la Riponne 5
1005 Lausanne
tél. 021 320 12 62
www.mda-vaud.ch



O

Office cantonal de l'assurance-invalidité (Zyra kantonale e sigurimit invalidor)
Avenue Général Guisan 8
1800 Vevey
tél. 021 925 24 24
www.aivd.ch

Office vaudois de l'assurance-maladie (OVAM) (Zyra vaudeze e sigurimit të sëmundjeje)
Chemin de Mornex 40
1014 Lausanne
tél. 021 557 47 47
www.vd.ch/subsidi-assurance-maladie

P

Point Info-Seniors (Pika Info-te Moshuarit) Espace Riponne place de la Riponne 5
1005 Lausanne
tél. 021 641 70 70
www.prosenectute.ch/cours-formation/point-infos-seniors

Pro Senectute Vaud
Rue du Maupas 51
1004 Lausanne
tél. 021 646 17 21
www.prosenectute.ch

Programme AvantAge

(Programi AvantAge)
Rue du Maupas 51
1004 Lausanne
tél. 021 711 05 24
www.avantage.ch

S

Service des Assurances Sociales et de l'Hébergement - SASH (Shërbimi i Sigurimeve Shoqërore dhe Strehimit)
Avenue des Casernes 2
1014 Lausanne
tél. 021 316 51 51
www.vd.ch/vivre-a-domicile

Service des assurances sociales de la Ville de Lausanne (Shërbimi i sigurimeve shoqërore të Qytetit të Lozanës), voir agence d'assurances sociales

Service social de la Ville de Lausanne (Shërbimi shoqëror i Qytetit të Lozanës)
Place Chauderon 4
case postale 5032
1002 Lausanne
tél. 021 315 75 11
www.lausanne.ch/csr

U

Université des seniors, Connaissance 3
(Univesriteti i të moshuarve, Njohuria 3)
Place de la Riponne 5
1005 Lausanne
tél. 021 311 46 87
www.connaissance3.ch

Dokumente që gjenden ne internet (përmes një motori kërkues)

Memento 3.01 : pensionet e pleqërise dhe alokacionet për pafuqi AVS

Memento 5.01 : ndihmat plotësuese për AVS-në dhe AI-në

Memento 5.02 : e drejta juaj për ndihmat plotësuese për AVS-në dhe AI-në

Tabelat

Për tabelat e pensioneve AVS/AI: www.bsylive.admin.ch/vollzug/documents/view/365/lang:fre/category:23



10.

Leksik



AVIVO

Shoqatë e të moshuarve që ndërmerr veprime për përmirësimin e kushteve të jetës të personave në pesion.

Arkat e kompensimit

Këto institucione kanë për detyrë të administrojnë në mënyrë të përditshme çështjet lidhur me sigurimet e shtyllës së parë (LAVS - LAI); ato administrojnë gjithashtu sigurimin e humbjes së fitimit (assurance perte de gain), në rast të shërbimit ushtarak apo të mëmësisë (maternité) (LAPG) dhe alokacionet familiare (LAFam). Çdo punëdhënës e përcakton vetë se në cilën arkë të kompensimit do të hyjë, duke e ditur se arka mund të jetë kantonale apo profesionale.

Arka zvicerane e kompensimit (Caisse suisse de compensation -CSC)

CSC ka për mision pikërisht zbatimin e konventave ndërkombëtare në fushën e sigurimit shoqëror; ajo është në dispozicion të shtetasve të vendeve të treta (shih UE/AELE - Bashkimi evropian/Shoqata europiane e shkëmbimit të lirë) për përcaktimin e të drejtave të pensionit të pleqërisë në vendin e origjinës.

Arkat e pensioneve

Këto institucione marrin përsipër administrimin e kapitaleve të të siguruarve. Ajo që mbahen nga rroga e punonjëseve dhe punonjësve prej punëdhënësve, përcaktojnë të drejtat e çdo të siguruari. e në kuadrin e shtyllës së 2të (LPP) për sa i përket pensionit të pleqërisë, të të mbijetuarve dhe të invaliditetit.

Billag SA

Organ i ngarkuar me arkëtimin e taksave që lidhen me përdorimin e radios dhe/ose televizionit, përfshirë internetin.

E ardhur e tatueshme

Fjala është për shumën që shërben si bazë llogaritjeje për tatimet federale, kantonale dhe komunale.

Fraternité (Vëllazëria)

Bëhet fjalë për një shërbim shoqëror veprues qysh prej 40 vjetësh në fushën e migrimit. Konsultoret shoqërore shpërndajnë informacione dhe këshilla, propozojnë mbështetje në plotësimin e përçapjeve administrative, shoqërore dhe juridike.



LAI

Ligji federal për sigurimin invalidor

LACI

Ligji federal për sigurimin e papunësisë

LAFAm

Ligji federal për alokacionet familiare

LAPG

Ligji federal për sigurimin e humbjes së fitimit në rast të shërbimit ushtarak dhe të mëmësisë

LAVS

Ligji federal për sigurimin e pleqërisë dhe të të mbijetuarve

LAMal

Ligji për sigurimin e sëmundjes

LCA

Ligji federal për kontratën e sigurimit; ai rregullon kontratat e sigurimit të shtyllës së 3të

LPC

Ligji federal për ndihmat plotësuese për AVS-në dhe AI-në

LPP

Ligji federal për parashikimin profesional të pleqërisë, të të mbijetuarve dhe invaliditetit

Mjetet ndihmëse

“Vegël” që synon t’i bëjë ballë, sidoqë pjesërisht, dobësisë të shikimit, të dëgjimit apo vështirësive të çvendosjes të një personi (pikërisht lupë, aparat dëgjimi, bastun).

Mosha e pensionit

Fjala është për moshën e parashikuar nga ligje të ndryshme për marrjen e përfitimeve pas daljes në pension; ajo është 64 vjeç për gratë dhe përkatësisht 65 për burrat; gëzimi i parakohshëm i të drejtave të pensionit apo shtyrja e tyre është i mundur.

OFAS

Zyra federale e sigurimeve shoqërore (Office fédéral des assurances sociales).

Pafuqia

Do të thotë të kesh nevojë në mënyrë të vazhdueshme për ndihmën e një personi të tretë në përmbushjen e veprimeve të jetës së përditëshme për arsye të një cënimi të shëndetit fizik dhe/ose psikik.

Partneritet i regjistruar

Bashkim që mund të celebrimet midis dy personave të të njëjtës gjini; në Zvicër, partneriteti i regjistruar nuk mund të përfundohet nga një çift me gjini të ndryshme.

Pensioni

Shumë që i derdhet një personi në bazë mujore, përgjithësisht nga një sigures shoqëror, në veçanti në kuadrin e shtyllës së 1rë (LAVS) apo të shtyllës së 2të (LPP).

Përqindja e shtesës

Bëhet fjalë për përqindjen, që përcaktohet nga mosha e të siguruarit.ës, duke shumëzuar rrogën e bashkërenduar (rroga që përfshihet midis CHF 24'675.- dhe CHF 84'600.-⁶³), dhe rezultati çohet në kredi të kapitalit të pleqërisë të personit përkatës .

Përqindja e kthimit

Bëhet fjalë për përqindjen me të cilën shumëzohet kapitali i pleqërisë i arritur në moshën e pensionit, duke përcaktuar kështu pensionin vjetor në kuadrin e shtyllës së 2të (LPP); ajo është 6,8%⁶⁴ (vlera 2017).

TVA (TVSH)

Taksa e vlerës së shtuar është një tatim jo i drejtpërdrejtë mbi konsumin, e cila merret gjatë blerjes të mallrave (veshje, vetura, ushqime) dhe të shërbimeve (berberi, transportet, vaktet në restorant).



63 Neni 8 par.
1 LPP

64 Neni 14 par.
2 LPP

UE/AELE (BE/AELE)

Fjala është për Bashkimin europian, i përkufizuar si shoqatë e Shteteve europiane. Ai ka 28 anëtarët vijues (UE-28): Gjermani, Austri, Belgjikë, Bullgari, Qipro, Kroaci, Danimarkë, Spanjë, Estoni, Finlandë, Francë, Greqi, Hungari, Irlandë, Itali, Letoni, Lituani, Luksemburg, Maltë, Vendet e ulëta, Poloni, Portugali, Republika çeke, Rumani, Mbretëria e Bashkuar, Sllovaki, Slloveni, Suedi.

Britania e Madhe ka vendosur të “dalë” nga BE-ja (“Brexit/Breksit”), por data e saktë nuk dihet ende.

AELE-ja është Shoqata europiane e shkëmbimit të lirë, e cila përbëhet nga Islanda, Lih-tenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra.

Vendet e treta

Shih UE/AELE (Bashkimi europian/Shoqata europiane e shkëmbimit të lirë).





Albanais / Shqip

Anglais / English

Bosniaque / Bosanski

Espagnol / Español

Français

Italien / Italiano

Portugais / Português



BUREAU LAUSANNOIS POUR LES IMMIGRÉS
Place de la Riponne 10 - CP 5032 - CH-1002 Lausanne
T +41 (0)21 315 72 45
bli@lausanne.ch - www.lausanne.ch/bli